



PRANUAR ME: 16-11-2023
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO: 02/526
Nr.No.Br. 

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/_____

Datë: 14.11.2023

PROCESVERBAL

i mbledhjes së -VI- (gjashtë) të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës.

RENDI DITËS

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt të rregullt e mbajtur me datë: 28.04.2023, mbledhjes së pestë të mbajtur me datë:30.05.2023 dhe mbledhjes së parë urgjente e mbajtur me datë:30.06.2023.
- 2.Rishqyrtimi i vendimit nr.02/279 datë:30.05.2023, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-495/4 datë:29.06.2023.
- 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2023.
- 4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/317 datë:22.06.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës shoqërore /komunale për realizimin e projekteve të KEDS për zgjerimin dhe përfortimin e rrjetit të shpërndarjes dhe ndërtimin e trafostacioneve për regionin e Komunës së Malishevës.
- 5.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/271 datë: 03.05.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike.
- 6.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/382 datë:21.06.2023, për Ridestinimin e mjeteve për investime kapitale.
- 7.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/940 datë:05.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë privat, për interes publik, me rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në qytezën e Malishevës.
- 8.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrtat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022.
- 9.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, sipas rekomandimit të zyrës Kombëtare të Republikës së Kosovës për të gjeturat e vitit 2022.
- 10.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023.
- 11.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/202 datë:14.04.2023, e parashtruar nga Driton Krasniqi.
- 12.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/385 datë:14.03.2023, e parashtruar nga Adem Hoti.
- 13.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/637 datë:22.12.2022, e parashtruar nga Arijon Krasniqi

- 14.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/199 datë: 06.04.2023, e parashtruar nga Luljeta Telaku.
- 15.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/111 datë:27.02.2023, e parashtruar nga Sala Krasniqi.
- 16.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/138 datë:14.03.2023, e parashtruar nga Naile Kastrati.
- 17.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/141 datë: 16.03.2023, e parashtruar nga Shahe Thaçi.
- 18.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/151 datë:20.03.2023, e parashtruar nga Lema Paqarizi.
- 19.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/247 datë:18.05.2023, e parashtruar nga Gentrin Krasniqi.
- 20.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/160 datë:27.03.2023, e parashtruar nga Rexhep Gegaj.
- 21.Të ndryshme

Mbledhja u mbajt me datë: 31.07.2023 dhe filloi në ora: 10:10. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 22 asambleistë, drejtorë komunal,përfaqësues nga OSBE-ja,përfaqësues nga KDI, përfaqësues nga KFORI Zvicëran dhe zyra për informim. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës z.Argjend Thaçi.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhë në mbledhjen e gjashtë të Kuvendit të Malishevës. Të pranishëm jemi 22 anëtarë të kuvendit, përfaqësuesit nga OSBE-ja, dhe përfaqësuesit e KDI-së. Kemi kuorum dhe mund të vazhdojmë me punimet e seancës, dhe para se të fillojmë me rendin e ditës i kemi në dispozicion 30 min për debat jashtë rendit të ditës.

Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi: Përshëndetje për të gjithë!

Së pari dua të ju uroj mirë se ardhje gurbetqarëve, uroj që këto ditë të pushimit t'i kalojnë sa më mirë. Kemi disa shqetësime këto ditë dhe uroj që Komuna të mirret sa më shpejtë me këto qështje, e para ka të bëjë me furnizimin e ujit të pijes. Të gjitha fshatrat kanë probleme dhe uroj që sa më shpejt të mirren me këtë qështje dhe të zgjedhin problemin e qytetarëve.

Shqetësimi tjetër është mirëmbajtja e rrugëve lokale, kemi vërejt që në shumicën e rrugëve lokale kemi gropa, kemi dhe disa probleme të tjera që po e vështirësojnë lëvizjen.

Ndriqimi publik është një tjetër shqetësim ku në shumicën e fshatrave ka defekte dhe dihet që këto ditë numri i banorëve është më i madhë dhe shpresoj që sa më shpejt të mirreni e këtë qështje.

Shqetësimi tjetër është dhe te hyrja e mini tranzitit, Drejtor të kisha thënë të mirresh direkt me këtë qështje që aty të vendoset një semafor apo të bëhet një rreth rrotullim që mos të kemi aksidente që i kemi parë në këto ditë sepse ka pasur aksidente të rënda.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Qështja të cilën dua ta ngris sot është që kanë përfunduar zgjedhjet në bashkësi lokale dhe ajo çka është vërejtur në këto zgjedhje është mungesa e vajzave dhe grave. Unë dhe kur është miratuar rregullorja për bashkësi lokale, ku pastaj janë mbajtur dhe mbledhjet e kam pritur këtë qështje dhe kam kërkuar një plan pune nga Komuna se si do ti inkurajoj grat dhe vajzat që të marrin pjesë dhe ato në këto zgjedhje. Ajo që kam parë është se komuna nuk ka marrë asnjë hap konkret në angazhimin e saj për t'i inkurajuar që grat dhe vajzat të bëhen pjesëmarrëse në këtë proces, për pasoj kemi dalë me një zgjedhje të bashkësive lokale me një mungesë teje të theksuar të grave. Kjo është në kundërshtim me rregulloren që ky Kuvend e ka miratu, është në kundërshtim dhe me ligjin për Barazi Gjinore. Pyetja ime konkrete është si po mendohet të vazhdohet në këtë drejtim?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Përshëndetje për të gjithë!

Unë i kam disa pyetje për Drejtorin e Shëndetësis dhe pse ai ka vendos që mos me marrë pjesë në asnjë mbledhje në Kuvend, siç jeni në dijeni në qendrën e mjekësis familjare në Malishevë që një kohë kanë dalë në pension dy internist Besim Zogaj dhe Milazim Kryeziu, është dhe afër pensionit Dr. Mursel Gashi. A do të iniciohet procedura të plotësohen këto vende dhe të ju ofrohen shërbime qytetarëve? Qështja tjetër ndoshta e keni parë vite më parë janë bërë shpronsime për rrugën e tranzitit i kemi parë që kanë filluar dhe punimet, te pjesa lartë ku ndahet tranziti për me u lidh është ndërtuar një objekt afarist, kisha kërkuar nga Drejtori i Gjeodezis si ka mundësi që para një kohe të shpronsohet dhe të fillohet procedura dhe rregullimi i tranzitit, ndërsa tani të i lejohet një personi privat të ndërtoj në fillim të tranzitit.

Nga Drejtori i administratës kisha kërkuar të na sjell numrin e personave të cilët janë me kontrata konsulente, sigurisht e dini që është një formë që shkonë përmes prokurorimit. Duam ta dimë numrin e personave sa janë të punsuar me këtë lloj kontrate?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Përshëndetje për të gjithë!

Unë i kam disa pyetje dhe para ka të bëjë me Drejtorin e Shëndetësis, qështja e dezinfektimit për rriqra ka filluar si proces me u realizu në teren, mirëpo ajo qfarë kam parë është se si proces nuk është duke u përfunduar siç duhet, kam marrë dhe ankesa nga qytetarët. Fatmirësisht nuk kemi asnjë të infektuar nga rriqrat, por kemi numër të madh të pacientëve të cilët po kërkojnë trajtim në QKMF. Është mirë Komuna pasi po i dhuron parat dhe po e zbaton një kontrat, ta inspektoj atë kompani se si po funksionon.

Qështja tjetër ka të bëjë me ujë të pijshëm, kam shumë ankesa në shumë fshatra që nuk janë duke u furnizuar me ujë të pijshëm. Ata janë të lidhur me burimin e Bajës, por nuk po furnizohen sepse sipas tyre po keqpërdoret prej disa personave dhe kanë probleme të shumta me ujë të pijshëm. Duhet Komuna të inspektoj dhe këtu nëse ka keqpërdorime apo nëse ka keqshpenzim të ujit të pijes.

Qështja tjetër ka të bëjë me konkursin e arsimit për drejtor të shkollave, i cili është anuluar një konkurs mirëpo Drejtoria e Arsimit ka thënë që mbrenda 6 muajve do të hapet një konkurs tjetër dhe do të plotësohen vendet e zbrazëta por ende nuk ka ndodhur. Jemi në prag të fillimit të vitit shkollor dhe mendoj që është mirë në gusht me përfunduar ky proces që të gjitha shkollat të kenë drejtor të caktuar. Qështja tjetër ka të bëjë me Drejtorin e Urbanizmit, e kam ngrit dhe më herët këtë qështje ne jemi duke e bërë një hap të madh të investimeve në ndërtim, ne nuk jemi kundër, por po ka shkelje të procedurave ligjore, nuk po zbatohen procedurat ligjore në hapsirat publike në ato lokalitete ku po ndërtohen këto. Po flas për lagjen të QKMF-jë e cila nuk po respektohet përqindja të cilën e ka caktuar ligji 40 ndërtim, 60% gjelbërim. Kjo nuk është duke u respektuar ndoshta është mirë me dal dhe me kontrollu ku ka shkelje sepse pastaj po përfundojmë në një krahur urbanistike.

E kam parë një shpallje që janë ndarë shumë donacione për shumë klube sportive, janë ndarë shuma të konsiderueshme të parave mirëpo ka shumë klube sportive të cilave nuk janë di aktivitet sportive. Klubi Alpin, shikoni listen është i njëjti klub i cili merr 3-4 vite radhazi parat, mirëpo nuk ka asnjë aktivitet sportiv. E di që përmes Ministries kur janë ndarë donacione i është kërkuar informacione se qfarë monamente kanë vizituar i kanë kërkuar një raport.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Në cilësin e anëtarit të komisionit për zgjedhje të këshillave lokale, na erdh një pyetje nga Znj.Kastrati dhe e ndjeva obligim me ju përgjigj. Sipas rregullores së Kuvendit pjesëmarrja e grave në Kuvende zgjedhore dhe këshilla lokale ka qenë e obligueshme, ne kemi kërkuar në shumicën e kuvendeve të kemi pjesëmarrje femërore, por nuk kanë shprehur interesim për pjesëmarrje.

E shprehe si shqetësim pjesëmarrjen e grave se sa i rëndësishëm është ky proces dhe me qenë vetë grua dhe në kuvendin e këshillit në vendit e vet që ka qenë mos me qenë pjesëmarrëse kësaj i thojnë hipokrizi. Pasi qenka kaq e rëndësishme pjesëmarrja meqë ne qenka dashur me bërë më shumë si Komunë, si Kuvend me i thirrë gratë pse nuk e ke bërë këtë punë vetë.

Alban, për pyetjen që e bërë, sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative qendrat e bashkësive familjare nuk kanë të drejtë me pas specialist kjo është një fatkeqësi për neve. Pra këta që dalin në pension ti nuk mundesh më me pranë mjek të rinjë, vetëm spitalet kanë këtë të drejtë.

Argjend Thaçi: Faleminderit Halil!

Unë deshta me i dhënë përgjigje por ishte përgjigjia adekuate, ekziston dhe grupi i grave asambleiste i formuar në vitin e kaluar.

Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati: Kur flasim për hipokrizi, hipokrizi është kur e ki një qështje dhe e cekë dikënd që i drejtohes me emër dhe pastaj del jashtë. Qështja ime është se nuk mundeni me ja lënë fajin grave të tjera qoftë anëtare e Kuvendit Komuna, l qoftë si grup i grave asambleiste, kur pyetja ime ke për Komunën.

Pyetja ime ishte se cilët kanë qenë hapat konkret me ju përgjigj kësaj situate kur gratë hezitojnë?

Qfarë ka bërë komuna për me i inkuraj gratë për me marrë pjesë në këto zgjedhje?

Halili duhet ta di se përgjegjësia ka hirarki, të njëjtën pesh të cilën ka komuna që është në qeverisje nuk e kam unë si anëtare e Kuvendit Komunal.

Argjend Thaçi: Unë në cilësin e anëtarit të Komisionit, Kryetari dhe ky kuvend ja ka delegu kompetencat dhe përgjegjësit këti Komisioni në përbërje të cilit ju e dini cilët kan qenë, për mbarvajtjen e këti procesi zgjedhor. Komisioni ashtu siç kërkon legjislacioni në fuqi ka bërë njoftimet e parapara siq e kërkon ligji, dhe në momentin që kemi filluar procesin zgjedhor e kemi pasur të pamundur që të ndërhyjmë. Ne nuk kemi pasur asnjë ditë të vetme të lirë, sepse qdo ditë kemi pasur zgjedhjet në fshatra dhe nuk kemi pasur koh që të bëjmë fushata sensibilizuese për pjesmarrje të gjinis femrore. Një rol të rëndësishëm keni mundur me dhënë ju si grup i femrave të paktën me një pjesmarrje simbolike, por arsyeja përse nuk keni marrë pjesë nuk e di përse ka qenë ky bojkot nga ana e juaj.

Urdhëro, Avdi Morina!

Avdi Morina: Përshëndetje për të gjithë!

I ngritët shumë qështje dhe bëtë shumë mirë, sepse puna e përbashkët e jona dhe vërejtjet e juaja pa marrë parasysh grupin parlamentar që i takoni na ndihmon shumë që gabimet të cilat i kemi me i përmisuar.

Uji i pijes është një problem i cili Komuna e Malishevës po ballafaqohet me vështirësi, ju e dini që kemi marrë disa tentativa që ta sigurojmë një zgjidhje afatgjate, mirëpo akoma nuk kemi diqka konkrete sa i përket zgjidhjes afatgjate, sepse një investim i tillë ka një kosto financiare shumë të madhe. Ne si Komunë kemi bërë një kontrat me hidroregjionin jugor që ti ndihmoj në asistimin e disa pompave të ujësjellësit.

Te mirëmbajtja e rrugëve lokale, në disa vendbanime kemi përfunduar disa rregullime por kemi dhe shumë të tjera dhe besoj që pas sezonës do ta bëjmë renovimin e disa rrugëve lokale për disa vendbanime

të Komunës së Malishevës.

Ndriqimi publik ne kemi kontrat për mirëmbajtje, kemi kërkesa me shkrim por kemi probleme nganjëher po shkojn po i dëmtojnë vetë.

Rruga tranzitit dhe ne e kemi parë që ka vështirësi ajo rrugë dhe kemi diskutuar dhe e kemi parë të arsyeshme me vendos disa semafor. Besoj ta votoni në vitin e ardhshëm që të ndahen një pjesë e financave për vendosje të këtyre semaforëve që të rregullohet komunikacioni në atë pjesë.

Te qështja e zgjedhjes së Këshillave lokale, është Komisioni që është përbër në asamble, dhe grat asambleiste është dashur të dhëjnë sa më shumë kurajo që të ketë sa më shumë pjesmarrje të grave në zgjedhjet lokale.

Qështja e ndërtimit të objekteve pajtohem plotësisht Veton dhe kishte qenë mirë që ju kuvendi me marr një vendim që me i ndërpre përkohësisht ndërtimet. Unë vetëm jam i shqetësuar që degradohet qyteti për arsye të ndërtimeve, mënyra e ligjit e cila dhuron mundësin 40-60% e dëmton qytetin sepse nuk po kemi hartë apo plane rregulluese urbane përveq zona e lagjes Mirdita, e cila e ka planin, ndërsa pjesët tjera të Malishevës nuk kanë. Ne kemi dokumentin në planin zhvillimor e cila është e miratuar para disa viteve, dhe në proces e kanë zgjedh qështjen e projektimit të hartave zonale për Malishevën, ne e kemi dërguar në Ministrin e Mjedisit të planifikimit hapsinor dhe ministria e mjedisit të planifikimit hapsinor i ka bërë disa ndryshime dhe rekomandime që duhet të bëhen dhe fatkeqësisht ne duhet ta pranojmë një fakt të vërtet që ne si drejtori nuk kemi kapacitete profesionale për rregullimin e atyre vërejtjeve dhe sygjërimeve. Për këtë arsye ne kemi filluar një procedur të shpalljes siç e kanë bërë shumica e komunave, që të aplikojnë kompani të profesionalizuara për hartimin e hartave zonale.

Argjend Thaçi: Nëse nuk kemi ndonjë gjë për të shtuar, kalojm te rendi i ditës kemi dy kërkesa nga zyra e kryetarit.

Kërkesa e parë që të hyjë në rend të ditës është: kërkesa 04/487, me anë të kësaj shkrese kërkojm nga ju nëpërmes asambles të miratohet kërkesa për rritjen e kufirit të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 për shumën prej 6000.00E. Shuma e cekur më lart të caktohet për projektet: Rregullimi i qendres, sheshit të Malishevës kodi i projektit 51787 shuma 300,000.00E, Rregullimi i rrugës "Ibrahim Mazreku" në Malishevë kodi i projektit 51771 shuma 200,000.00E, Asfaltimi i rrugëve në fshatra kodi projektit 53427 shuma 100,000.00E. Arsyetim kërkesa për rritje të kufirit për të hyra vetanake bëhet për arsye se në muajin Korrik është realizuar planifikimi i të hyrave vetanake për vitin fiskal 2023 në shumën prej 1.158,603.00E andaj për periudhën e mbetur për këtë vit do të realizojmë të hyra shtes në shumën 600,000.00E.

Kemi kërkesën e dytë e cila është: nr 01/1040, kërkes për shqyrtim dhe miratim të raportit të Komisionit Komunal për vlersimin e dëmeve në bujqësi në fshatrat e Komunës së Malishevës. Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës së Malishevës duke vepruar në pajtim me ligjin për Vetëqeverisjen lokale ligji nr. 03/L-040, gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, datë: 04 Qershor 2018, neni 4, 8,16,17 par.17.1 shkronja (g) neni 58, si dhe duke marrë për bazë, raportin nr.08/758, datë : 28.07.2023, të komisionit komunal për vlersimin e dëmeve në Bujqësi, fshatrat e Komunës së Malishevës, ju paraqesë për shqyrtim dhe miratim këtë raport si dhe listën me emrat e përmbledhur të fermerëve të vlersuar nga Komisioni i cekur, e që kanë pësuar nga fatkeqësitë natyrore, ktyesisht në kulturat bujqësore. Pas miratimit nga ana e juaj të kësaj kërkesë-raporti, i njëjti do të procedohet në organet kompetente ligjiore për ndihmë financiare për këta fermerë.

E hedhi në votim, kush është që kjo kërkes me nr. 04/487 të hyjë si pikë e rendit të ditës?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me 20 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime hynë si pikë e rendit të ditës.

25 anëtar jemi prezent.

E hedhi në votim kërkesën e dytë nr.01/1040, kush është që kjo kërkesë të hyj si pikë e rendit të ditës?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 5

Me 20 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime hynë si pikë e rendit të ditës.

A ka dëshiron dikush fjalën për rend të ditës?

Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë!

Sa i përket qështjes së rendit të ditës, unë kërkoj që kërkesa nga bizneset të futet në rend të ditës dhe nëse i merr votat në rregull nëse nuk i merr prap në rregull.

Lënda: Kërkesë për lejimin e subjekteve afariste gastronome për shërbim me shisha llulla e të ngjajshme, kuvendi Komunal në Malishevë me kërkesën e Kryetarit të Komunës z. Ekrem Kastrati me datën:

11.10.2022 për ndalimin e shërbimeve shisha, llulla, në subjektet afariste gastronome dhe të ngjajshme në territorin e Malishevës, kuvendi komunal e ka miratuar kërkesën me vendimin e kuvendit komunal nr.02/500 datë: 19.10.2022 i cili ka hyrë në fuqi me datën 16.01.2023 për të cilin vendim subjektet afariste janë njoftuar nga Drejtoria e Inspektoriatit me njoftim nr. 07/1025 datë: 13.12.2022. Në subjektet afariste jemi të dëmtuara nga ky vendim pasi që ne si biznese kemi obligime financiare ndaj qiras, puntorëve, paguajmë tatime dhe kemi kredia dhe banka në emër të biznesit. Jemi mbajtës të familjes, kjo veprimtari nuk është e ndaluar në asnjë Komunë të Republikës së Kosovës vetëm në komunën tonë. E njoftojmë kuvendin komunal të Malishevës se në të gjitha marketet e Kosovës dhe në marketet e Komunës së Malishevës shiten shisha për cigare elektronike të cilat janë shumëfish më të dëmshme se shisha llulla dhe nuk ju ka ndaluar shitja e tyre. Ndërsa neve si subjekte afariste gastronomi dhe të ngjajshme në Komunën e Malishevës me vendim të Kuvendit Komunal të Malishevës na është ndaluar vendimi me shisha llulla dhe mjete të ngjajshme. Komuna e Malishevës përkatësisht Drejtoria e inspektoriatit ka pasur mundësi që të ketë mbikqyrje të shtuar në këto subjekte afariste përmes inspektorëve në teren për të vërtetuar se a po zbatohen rregullat dhe mosha e caktuar dhe jo të veprojnë një anshëm duke na ndaluar shërbimin me shisha në subjektet afarise gastronomi dhe të ngjajshme në territorin e Komunës së Malishevës. Pasi që një shërbim i tillë në Komuna të tjera nuk është ndaluar kërkojmë nga Kuvendi Komunal që ta shfuqizojë vendimin me nr. 02/500 datë: 19.10.2022 dhe të na lejoj shërbime shisha llulla konform dispozitave ligjore. Kërkoj që kjo kërkesë të futet në rend të ditës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton!

Veton Zogaj: Unë kërkoj të largohen nga rendi i ditës dy pika, pika e 4 dhe pika e 5. Pika e 4 ka të bëjë me kërkesën e KEDS-it për hapsirat publike të cilat i ka kërkuar. Ndërsa pika e 5 është kërkesa e Enver Mazrekut sa më kujtohet në dy seanca më herët e kemi rrëzuar në kuvend si kërkesë me vota shumicë dhe nuk është mirë prap me sjellë në Kuvend.

Pikë shtesë kërkoj të futet në rend të ditës ndryshimi i vendimit për themelimin e Komisionit për zgjedhje në fshatra, të bëhet pagesa dhe për Valonin dhe Arsimin të cilët na kanë ndihmuar shumë si Komision e kanë përfunduar punën e logjistikës dhe të ju bëhet pagesa e njëjtë si për ne dhe për këta.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne anëtarët e Komisionit e kemi diskutuar këtë qështje dhe e kemi parë të arsyeshme që të ju sigurohet një pagesë dhe për këta anëtar si për ne, për arsye se kanë bërë punë më shumë se ne. Ne si grup parlamentar e votojmë si pikë.

Argjend Thaçi: Vetoni, propozoj që të jenë pjesë e Komisionit, por kjo nuk është e mundur, kisha kërkuar një konsult me Drejtorin e Financave dhe me Muharremin në mënyrë që ta kemi vendimin vetëm për pagesë të këta dy anëtar sepse kanë bërë një punë të jashtëzakonshme.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Unë propozoj që në kuadër të këtij vendimi që është nxjerr për themelimin e këtij Komisioni duhet të plotësohet ai vendim me pjesën logjistike dhe me pjesën mediale që është mbulu komplet si proces që është bërë.

Alban Kastrati: Dhe unë pajtohem me kolegët që këta e kanë bërë një punë të jashtëzakonshme dhe sigurisht do ta gjejnë mënyrën se si të ju bëhet pagesa sepse kanë ardhë dhe në orë të vona.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon!

Valon Krasniqi: Edhe unë pajtohem që të paguhet, mirëpo para se të bëhet implementimi i këtyre pagesave, të bëhet pagesa e të gjitha komisioneve të cilat nuk janë paguar deri më tani.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Po filloj nga Valoni se çdo komision që nuk është paguar deri më tani do të gjejnë një mënyrë të paguhet por duhet të dimë se sa kemi para të paguajm. Ne kemi shqyrtuar një mundësi për ti përfunduar këto obligime por nuk po ka para të mjaftueshme për të përfunduar çdo muaj. Kemi pasur dhe kërkesën tjetër e cila ende nuk është kthyer nga MAPL-ja vendimi përfundimtar për pages të këtyre. Ndërsa te pjesa e këtyre dy anëtarëve që kanë qenë te pjesa e logjistikës, mund të i plotësohet dhe vendimi për pjesën logjistike për të dy kandidatët. Për Arsimin mundet me qenë dhe më lehtë, sepse mundet me ja shenu një raport dhe të paguhet për punën shtesë si zyrtar nga Drejtoria e administratës, ndërsa për Valonin është pjesë e zyrtarit konsulent nuk e di a mundet të i bëhet ndonjë raport mirëpo më lehtë do të ishte me një vendim të juaj të jetë pjesë shtesë e pagesës për logjistik të këtyre dy anëtarëve.

Argjend Thaçi: Duhet ta bëjmë një vendim të veçantë sepse ai është vendim sipas udhëzimit administrativ që nuk parasheh tjetër.

Kalojm te votimet kërkesa e Valon Krasniqit ishte anulimi i vendimit për shisha llulla, kush është për futje në rend të ditës të kësaj kërkesë?

Për: 4

Kundër: 13

Abstenim: 7

Me 4 vota për, 13kundër, 7- abstenime nuk hynë si pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te propozimi i Vetonit për heqjen e pikës së 4 dhe pikës së 5 nga rendi i ditës. Kush është për që të largohet nga rendi i ditës pika e 4?

Për: 6

Kundër: 15

Abstenim: 3

Me 6 vota për, 15kundër, 3abstenime pika e 4 mbetet si pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te pika e 5, kush është për që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës?

Për: 6

Kundër: 14

Abstenim: 1

Me 6 vota për, 14kundër, 1abstenim pika e 5 mbetet si pikë e rendit të ditës.

Kalojmë te propozimi për pages të stafit teknik të Komisionit për zgjedhje të këshillave lokale. Kush është që kjo pikë të hyjë si pikë e rendit të ditës?

Me 22 vota për, asnjë kundër, 2-abstenime kjo pikë hynë si pikë e rendit të ditës.

E hedhim rendin e dites me plotësim ndryshime të bëra, kush është për miratimin e rendit të ditës?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 21 vota për, asnjë kundër, 2abstenime miratohet rendi i ditës.

Vazhdojmë me pikën e parë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalëve nga mbledhja e katërt të rregullt e mbajtur me datë: 28.04.2023, mbledhjes së pestë të mbajtur me datë:30.05.2023 dhe mbledhjes së parë urgjente e mbajtur me datë:30.06.2023. A ka dikush të diskutoj te kjo pikë?

Nëse jo, kush është për miratimin e kësaj pike?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 19 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojm me pikën e dytë e cila është: kërkesa nr. 04/487 me anë të kësaj kërkesë kërkojm nga ana e juaj përmes asambles Komunale për rritjen e kufirit të hyrave vetanake për vitin 2023 shumën prej 600,000.00E. 300,000.00E për kodin e projektit 51787, kodi i dytë i projektit rregullimi i rrugës "Ibrahim Mazreku" 51778 dhe asfaltimi i rrugëve kodi 53427 shuma prej 100,000.00E.

Urdhëro, Drejtor Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Është një gjendje e mirë e realizimit të hyrave në kuvendin komunal në komunën tonë, dhe në diskutim me Ministrin e Financave duke pasur parasysh që do të kemi mbi realizim të hyrave, që të bëhet e mundur realizimi i shpenzimit për këtë vit është dashur të drejtojm një kërkes për periudhën e mbetu, të nxerrim një vendim për realizimin e shpenzimit. Për këtë arsye është bërë kjo kërkes drejtuar asambles që të përfundohet realizimi i shpenzimit në këtë vit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Ne e shikuar kërkesën dhe arsyeja që ne e votuam që të hyjë kjo kërkes në rend të ditës është për arsye se ka një ngritje të hyrave vetanake, por ajo qka nuk po pajtohem me këtë është po orientohen vetëm në dy projekte aktuale të cilat janë duke u punuar. Është mirë të shpërndahet dhe në projekte të tjera jo vetëm në këto dy projekte, jemi për dhe mirë që po ndërtohet dhe rregullohet rruga por jo me bartë të gjithë buxhetin vetëm në këto dhe fshatrat tjera me mbetë pa investime.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Kur ne përballemi me kësi lloj kërkesë me ngrit nivelin e të hyrave vetanake kjo i bie që është duke u bërë një punë e jashtëzakonshme e qeveris komunale, e administratës së komunës për inkasimin e këtyre të hyrave. Orientimi i mjeteve në këto dy projekte të mëdha që po implementohen në komunën tonë, e që janë duke e transformuar totalisht qytetin tonë dhe jemi duke e parë efektin e këtyre investimeve dhe pse u përfundu vetëm një fazë e këtij projekti për Malishevën Urbane. Qyteti i Malishevës po e tejkalon problemin e vërshimeve, është zgjeruar, është liruar hapsira publike, i është shtuar dimensionin estetik. E kemi parë qfarë efekti pozitiv ka shkaktuar te bizneset të cilat janë për gjatë bulevardit “Ibrahim Mazreku” në mbrëmje gastronomia nuk ka kapacitet me i plotësu nevojat dhe kërkesat e klientëve. Kështu që unë e votoj këtë kërkesë dhe i destinoj parat në këto dy projekte të cilat janë duke u bërë në komunën e Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Përshëndetje për të gjithë!

Pak a shumë ato elementet investive të projektet kapitale i referoj shefi i grupit, unë dëshirova të i falenderoj të gjithë qytetarët, të gjithë bizneset të cilët janë të përgjegjshëm ndaj obligimeve të tyre ndaj komunës. Drejtorit më herët ja bëtë një pyetje se përse nuk janë paguar Komisionet dhe Drejtori e ceki që në mungesë të mjeteve nuk kemi mundur të i paguajm, kisha kërkuar që një pjesë prej 300000E të ndahet dhe të paguhen komisionet të cilat nuk janë paguar. Këto mjete nuk kanë qenë të planifikuara me u destinu në këto projekte, mirpo pasi që kanë ardhur si rezultat i inkasimit të të hyrave është i domosdoshëm ngritja e nivelit e të hyrave dhe kisha kërkuar që pa i cenuar projektet me i përfundu obligimet ndaj komisioneve. Ju e dini drejtor se nga cili projekt e merrni një shumë i cilin nuk cenohet projekti në fjalë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Krasniqi!

Valon Krasniqi: Sa i përket këtyre bartjes së mjeteve ne votuam që të hyjë në rend të ditës besojmë që do ta votojmë në fund. Një sqarim nga drejtori i Financave për asfaltimin e rrugëve në fshatra ku shuma është 100000E, rrugët të cilat nuk janë asfaltuar me kohë a do të asfaltohen ato rrugë të reja. Sa i përket projekteve të reja siq e cekën dhe kolegët është duke u bërë një punë e mirë, sepse ne këtu jemi që ta përfaqësojmë interesin e qytetarëve mirëpo jemi duke e parë që një pjesë tjetër e Malishevës është duke u vetëshkatërru. Duhet ta kemi parasysh që edhe këto rrugë janë bërë me taksa të qytetarëve dhe Drejtoria e Inspektoriatit duhet të fokusohen dhe në ato rrugë sepse janë duke u vetëshkatërruar.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Valon Mazreku e ngriti një shqetësim që është me të vërtetë shqetësim i joni si anëtar të Kuvendit. Ka Komitete obligative ka Komitete jo obligative, komisione obligative, mirëpo sa më kujtohet vetëm një herë ka dalë një shumë e vogël si anëtar i komisionit obligativ të aksionarëve të stacionit të autobusëve, dhe në shumë komisione të cilat kemi marrë pjesë ne nuk kemi marrë asnjë pages. Kur është marrë një vendim për komisione obligative unë nuk kam qenë këtu siq është komisioni i aksionarëve të cilët janë shumë të rëndësishëm dhe kanë punë të përditshme të paguhen vetëm 6 mbledhje në vit, shikoni praktikën e komunave të tjera qfarë i kanë për komisionet e aksionarëve të cilët kanë punë të jashtëzakonshme. Në seancën e radhës do ta trajtojmë këtë çështje dhe do të bëjmë kërkesë adekuatë, nëse Komuna ka para për gjithqka tjetër duhet me pas dhe puna e kuvendit sepse është një punë shumë e mundimshme.

Argjend Thaçi: Sa i përket anës së sekretaris së kuvendit jemi në rregull sepse kam bërë kërkesë që të kryhen këto pagesa, por gjithmonë kanë qenë arsyet e njëjta mungesë e mjeteve financiare. Dhe ne presim nga ekzekutivi qasje më korrekte ndaj anëtarëve të komisioneve të cilat formohen nga anëtarët e Kuvendit. Urdhëro, Hamit Lima!

Hamit Lima: Përshëndetje për të gjithë!

Unë dua të ndërlidhem te Halili te lirimi i pronave publike dhe është mirë që është bërë lirimi i pronave publike, por prap këto prona janë duke i shfrytëzuar. A janë duke e bërë ndonjë pagesë apo si janë duke i shfrytëzuar ato?

Qështja dytë e cekët që ju kan rritur të hyrat bizneseve, ju kan rritur vetëm dy apo tri bizneseve jo bizneseve të tjera. Rruga nuk ju shton të hyra bizneseve, sheshi nuk ju shton të hyra bizneseve ju shton vetëm kafiterive.

Dhe një qështje tjetër mos po e teprojmë me lejimin e DJ dhe me qeshë Komunitet të tjera me ne, kisha kërkuar mos të lejohen DJ në shesh.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Hamiti e ngriti një shqetësim ku e cekti që vetëm disa bizneseve ju ka rritur puna në atë shesh, gjithmonë njerëzit hapin biznes atë qfarë klientela kërkon nëse ju ka ngritur të hyrat kafiterive hape dhe ti një kafiteri. Për punën e DJ shoqëria duhet me kriju kushte për të gjitha kategorit secili ka të drejtë me bërë qefin në formën e vetë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Hamit Lima!

Hamit Lima: Unë nuk kam biznes në atë pjesë, por ajo që the me mbyll biznesin dhe me hap kafiteri ky është një mendim shumë i keq. Duhet me pas një rregullore për të gjitha bizneset sepse qdo ditë janë duke u hapur biznese të njëjta.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: E ndëgjova me shumë kujdes Hamitin, në disa pika e mbështes, mirëpo sa i përket qasjes apo mënyra se si u qas ky te rruga e "Ibrahim Mazreku", shumë njerëz janë të lidhur me biznesin dhe nuk është e thjeshtë me ndryshu komplet veprimtarin gjithë që pajtohem me të por munden me ndryshu lokacionin.

Kam informacion që të gjitha ato biznese të cilat e shfrytëzojnë pronën publike nga ora 20:00 deri në ora 24:00 ato kanë marrë një leje në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, lejet i lëshon duke u bazuar në rregulloren për taksa dhe ngarkesa të cilën e kemi miratuar në Kuvend. Pra te shfrytëzimi i pronës publike në periudhë afat-shkurtër, ata paguajnë një tarif shtesë varësisht se si është në rregullore e përcaktuar. Ndoshta është njëri prej faktorëve për me u rrit tavani i të hyrave vetanake.

Sa i përket bizneseve aty që operojnë, Hamiti e cekti që ne do të duhej përmes ndonjë rregullore me i ndal mos me u hap vetëm kafiteri apo mos me u hap ndonjë biznes për arsye të konkurrencës, kjo ndodh vetëm në shtetet përëndimore ku e masin se a ka nevojë ky vend për këtë biznes, ne nuk e kemi këtë standart.

Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Blerim Thaçi: Të hyrat vetanake shtesë janë të orientuara në tri projekte, këto tri projekte janë projekte tri vjeqare dhe i kemi shtuar që ta letojmë buxhetin për vitin e ardhshëm fiskal. Te bulevardi është një kontratë e cila do të përfundojë në këtë vit edhe pse është e planifikuar për vitin e ardhshëm dhe ne lirohemi ndaj obligimit kontraktues ndaj këtij operatori.

Për rrugët të cilat janë duke u punuar dhe do të përfundojnë kanë qenë të planifikuara për këtë vit 500.000.00E ato janë në përfundim, dhe janë shtesë dhe 100.000.00E për rrugë ekzistuese për këtë vit. Te projekti i sheshit kemi kërkuar me u bart mjete për arsye që ta lehtësojmë për vitin e ardhshëm, sepse kemi një ngarkesë më të madhe për vitin 2024 kështu që për vitin 2025 të zvogëlohet kjo ngarkesë.

Qështja të cilën e ceki Valoni, një gjë e din mir se sa mjete ndahen te kapitali dhe sa te mallra dhe shërbime, ne nuk mund ti përcaktojm kufit. Kufit kanë qenë në buxhetin final të vitit 2023 dhe ajo është plotësuar te mallra dhe shërbime, është një pjesë te shëndetësia dhe arsimit që jemi të obliguar me i bartë. Obligimet të cilat janë nga Kuvendi Komunal do të përfundojnë, takimin e fundit të cilin e kemi pasur me Ministrin e financave për qështjen e shqyrtimit të buxhetit për vitin 2024, mbi bazen e praktikave të Komunave të tjera Komisionet e Kuvendit të asambles besoj që do të kalojnë për pages te kategoria e pagave dhe shtesave. Ne jemi duke e shqyrtuar këtë sepse mallra dhe shërbime nuk po na mundësojnë me i përfundu të gjitha obligimet, por sido që të jetë ne këto obligime do të i përfundojm.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Ministria e Financave nuk e kufizon se a mundemi me qu mjete në projekte të reja, Ministria e financave kërkon që fillimisht duhet të buxhetohen obligimet kontraktuale të cilat janë. Komisionet të cilat janë mbajtur deri më tani unë konsideroj që janë obligime të Komunës ndaj anëtarëve të atyre Komisioneve dhe nuk e pengon Ministrin e Financave se ku me i vendos mjetet. Sa i përket buxhetit final i cili është miratuar, buxheti i miratuar mundet me u ndryshu disa herë, rasti konkret kur ne si Komun i kemi grumbulluar të gjitha të hyrat të cilat i kemi pasur të planifikuara për këtë vit fiskal, dhe për me ja bërë vendin këtyre të cilat do të vijnë për muajt e ardhshëm atëherë do të duhet me bërë rritjen e tavanit dhe me cek projektin. Në këtë rast ne mundemi me i dërgu dhe te kategoria e mallrave dhe shërbimeve, sepse dhe tavani i kapitaleve ka qenë i kufizuar me buxhet por tani ne e rrisim për arsye se kemi të hyra më shumë se që i kemi planifikuar ne.

Unë kisha kërkuar një pjesë nga cili do prej këtyre projekteve 20.000.00E apo 30.000.00E me u nda për me u pagu këto Komisione. Ne po duhet me lënë punën qoftë në shkollë apo ndonjë punë tjetër, ku në shkollë neve na ndalin mëditjen kur nuk po i mbajmë orët për me mbajtë atë Komision në të cilin jemi. E cekën më herët Komisionin për ndryshimin e statutit, ne më shumë kemi punuar jashtë mbledhjes se në mbledhje, ne nuk po kërkojm më asgjë më shumë se nga ajo që na takon. Në qoftëse Ministria e Financave është duke pretenduar me u bartë te kategoria e pagave dhe shtesave është në rregull, por le ti paguan tani e tutje thjesht po kërkojm me respektu ligjin me i kry obligimet të cilat janë si rezultat i kuvendit.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Nuk thash Valon që nuk është duke e lejuar Ministria, këto obligime kanë me u përfunduar. Nuk mund të barten nga një projekt i ri sepse projekti duhet me u miratu, ne kemi kërkuar me u bart në projektet ekzistuese për arsye se e kemi më lehtë. Qarkoren e parë e kemi aprovuar me 500.000.00E shtesë te të hyrat vetanake për vitin 2023, mirëpo Ministria nuk na ka lejuar qështjen e kalimit të kufive të planifikimit të buxhetit për vitin 2023. Ka thënë që realizoj të hyrat çka ke planifiku dhe fillo me kërkesën për mjete shtes që i realizon të hyrat.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Ministria e Financave nuk mundet me na vendos kufizime, sepse logjikisht munden me u përfundu projektet mbrenda vitit fiskal, por thotë kusht është me i mbulu kontratat. Ne nuk po kërkojm nga grandit i arsimit, as nga grandit i shëndetësis por këto janë mjete të cilat janë të pa definuara. Ne po kërkojm me i definu në kuadër të këti definimi 30.000.00E me i nda për pagesat e Komisioneve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Mendoj që rruga më e duhur është kjo që po e cek Valoni, me hedh propozimin e Valonit në votim është qështje e Kuvendit nëse i merr votat apo jo me i nda 30.000.00E për këtë kategori.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Në fillim u cekë që për arsye të mungesës së mjeteve nuk janë paguar këto, tani propozimi i Valonit pasi që nuk kemi mjete të i destinojm një pjesë të këtyre mjeteve të hyrave vetanake për komisione. Drejtori thotë që kemi me gjetur mënyr me i pagu pa pasur nevojë të ndahen këto mjete, nëse keni mundur me gjet mënyrën ju deri më tani i kishi paguar, nëse nuk je i sigurt të i ndajm këto mjete dhe të përfundohen këto obligime.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Ajo që thua nuk keni mundur me i pagu deri më tani po i paguan tash, kemi pasur obligime te mallra dhe shërbime duke filluar te lëndët djegëse, dru, pelet, shujta ushqimore për fëmijë deri sa ka përfunduar procesi mësimor. Dhe për këtë periudh Korrik-Gusht shpenzime të natyrës së till nuk ka pasur. Planifikimin e mallrave dhe shërbimeve e kemi mujore për muajin Korrik-Gusht dhe Shtator jemi më të lirë për shpenzime shërbime dhe në mes të këtyre muajve 30.000.00E gjenden më lehtë. Sido që të jetë ju mundeni me aprovuar është e drejtë e juaja.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Kuvendi e ka buxhetin e vetë, të gjitha Komitetet paguhen në bazë të udhëzimeve administrative unë nuk e di që janë shfuqizuar. Atë qka e ka kërkuar ekzekutivi nga ne me realizu e kemi bërë atë vendim që të gjitha komitete të formuara nga asamblea me u pagu. Ajo qka kam dëgjuar që ka komitete të cilat janë paguar dhe ka komitete të cilat asnjë mbledhje nuk ju është paguar. Ne po e kërkojm atë qka na takon, nuk po dëshirojm me shkel ligj. Më herët nuk dëshirova qëllimisht me marrë fjalën për Komisionin për zgjedhjen e bashkësive lokale, ky kuvend ka votuar jashtëligjshëm e ka votuar dhe përbëmjen e Kuvendit që nuk ka pasur përfaqësim gjinor dhe e ka bërë pagesën 100E, me qfarë të drejte?

Argjend Thaçi: Labinot ne e kemi një konfirmim të Komisionit për zgjedhjen e këshillave Lokal pra na është kthyer konform ligjshmëris, sepse përndryshe nuk kishim guxuar me vepru, te pagesa është vendimi për Komisione jo obligative ndërsa për Komisione të veqanta nuk e specifikon sa duhet me qenë shuma. A ka dikush tjetër për diskutim, nëse jo e hedhim në votim propozimin e Valon Mazrekut.

Kush është për propozimin e Valonit, kërkes që nga rritja e të hyrave vetanake të ndahen 30.000.00E për mallra dhe shërbime. Pra të ndahen nga 10,000.00E nga secili kod i propozuar nga Kryetari.

Kush është për këtë plotësim-ndryshim?

Unanimisht miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojm me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Komisionit Komunal për vlersimin e dëmeve në bujqësi në fshatrat e Komunës në Malishevë, kërkesa 01/1040. Kemi këtu Drejtorin e Bujqësis për ta sqaruar këtë kërkesë.

Urdhëro, Drejtor Sylë Dukolli!

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë!

Faleminderit që e keni aprovuar si pikë jashtë rendit të ditës sepse dhe puna ka qenë shumë e jashtëzakonshme për arsye të reshjeve që e kanë përfshi një pjesë të territorit të Komunës tonë që kanë shkaktuar dëme në bujqësi. Kam të dhëna për ekonomin familjare, kam biseduar me Drejtorin për kërkim shpëtim dhe ka thënë që nuk është lajmëruar askush, ndërsa për dëme komisionet tona të bujqësi kanë dal në teren dhe e kemi gjetur në këtë gjendje siq e keni në raport. Më të dëmtuar është pjesa e Plloqicës një fshat ku ka ndodhur në familjen Shkëmbim Malokut ju ka dëmtuar pllaci 80 ari sipas llogaritjes që na ka dhënë programi dhe pse kërkesat e tij kan qenë më të ulëta, ju është llogaritur dhe pjesa e punës së dorës dhe është dalur kjo gjendje. Ai është program nuk mundemi me ndërhy, ne e kemi bërë si kërkes nuk është për me u dhuru nga Komuna. Në raport e keni që ne do të ju drejtohem Komisionit qendror. Janë përfshi këta fermer që i kemi në tabel vlere është 24,731.00E. ata të cilët jan të interesuar me pa punën e Komisionit tonë munden me dal në teren dhe me verifiku gjendjen e këtij raporti që ne e kemi thënë. Ndoshta më keni parë që i kam bërë disa intervista për disa media rreth kësaj gjendje por Ministria e

Bujqësis nuk ma ka bërë asnjë telefonat sa i përket kësaj çështje, është për tu ardhur keq. Unë kërkoj nga ana juaj që të ja dhuroni aprovimin tuaj këtij raporti, dhe pastaj të i drejtohem përmes Kryetarit të Komunës Komisionit Qëndror për mbulimin e dëmeve fermerëve të cilët ju janë shkaktuar në atë zonë. Kemi pasur kërkesa të vazhdueshme 12 ose 13 Komisioni i ka rrëzuar sepse nuk e kanë kaluar 30% që e kemi standartin.

Argjend Thaçi: Urdhëro Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Drejtori e ceki që janë dhe 12 ose 13 kërkesa, a janë të kësaj natyre dhe që nuk e ka kaluar % apo janë kërkesa të ndonjë natyre tjetër?

Sylë Dukolli: Kam pasur dhe të natyrës tjetër, por më shumë për të reshura por që nuk e kanë kaluar 30% e standartit.

Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e kërkesës nr.01/1040.

Unanimisht, për miratimin e kësaj kërkesë.

Vazhdojmë në pauz dhe rikthehemi prapë.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Rishqyrtimi i vendimit nr.02/279 datë:30.05.2023, sipas kërkesës së MAPL-së nr.020-495/4 datë:29.06.2023.

Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Sa herë na dërgohet materiali pra rendi i ditës këto vendime nuk na dërgoni, unë e shoh këtu nr. e vendimit por nuk e di për cilin vendim bëhet fjalë. Është mirë që herave të tjera kur kemi kësaj lloji shfuqizim të vendimeve me na dërgu së bashku me material të mbledhjes.

Argjend Thaçi: Atëherë së pari e vendosim për shfuqizim pastaj e hedhim në votim sipas kërkesës së MAPL-së e cila ka thënë me nda në zonë me interes dhe këmbim të pronës.

Kush është për shfuqizimin e këtij vendimi nr.02/279 sipas kërkesës së MAPL-së nr 020-495/4 datë: 29.06.2023?

Unanimisht shfuqizohet ky vendim, 22 anëtar prezent.

Kush është që kjo zonë të shpallet zonë në interes publik?

Për: 16,

Kundër: 0,

Abstenim: 6.

Me 16 vota për, asnjë kundër dhe 6abstenime miratohet kërkesa për shpallje të zonës në interes publik.

Kush është për këmbim të kësaj parcele?

Për: 16,

Kundër: 0,

Abstenim: 6.

Me 16 vota për, asnjë kundër dhe 6abstenime miratohet kërkesa për këmbim të zonës.

Kalojmë në pikën e radhës e cila është: 3.Shqyrtimi i Raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-qershor 2023. Urdhëro, Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Të gjithë e keni materialin besoj dhe unë do të fokusohem më shumë te pjesa e buxhetit për këtë periudhë që është bërë hartimi i mjeteve. Në përqindjen buxheti në total është 78.79%. Sipas shenimit të librit të thesarit shkalla e realizimit të shpenzimit të buxhetit është 78.51%. Kurse përqindja e tërësishme e buxhetit të shpenzuar në këtë periudhë është 11,395,454.68E që në përqindje është 61.86%, ndërsa deri në fund të këtij muaji rreth 89% është realizu shpenzimi i kapitaleve.

Sipas buxhetit të vitit 2023 të hyrat vetanake të planifikuara kanë qenë 1,158,603.00E. Në këtë muaj është shtuar realizimi i të hyrave të realizuara 100%, kërkuam të marrim aprovimin tuaj për të hyra shtes për këtë vit fiskal.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Unë po ndalem shkurt te tabela e të hyrave dhe shpenzimeve, si punë kemi përmissim të dukshëm të hyrave vetanake, por prap në disa kategori vërehet ose kemi humbje në raport ose nuk kemi inkasim fare.

Te certifikatat e lindjes 0 është dhe te certifikatat e vdekjes ndoshta hynë te certifikatat e tjera por mirë është kur të na sjellni raportin me i sjell këto kategori ndaras me i pa se sa ka të hyra prej këtyre kategorive.

Taksa komunale për ushtrim të veprimtaris unë nuk po e kuptoj për qfar veprimtarie po bëhet fjalë, pra në vitin 2022 e kemi pasur 20,291.10 ndërsa në vitin 2023 e kemi 4,650.00E është afër 16,000.00E më e vogël sesa në vitin paraprak. Shfrytëzimi i pronës publike është përgjysmimi i të hyrave vetanake në këtë kategori, nuk e di përse përveq pishinës dhe stadiumit që i keni dhënë në shfrytëzim këtë vit nuk e di qfarë prona të tjera keni dhënë në shfrytëzim.

Licea tjera për afarizëm në vitin 2022 ka qenë 190.90, ndërsa tani është 400.00E është shumë e ulët si e hyrë.

Pranimi teknik i lokalit është 30.00E nuk e di a shkojnë përmes inspektoriatit apo urbanizmit, nuk e di a bënë pranim teknik të lokalit kur i lëshojn në shfrytëzim ato dhe përse është një shumë kaq e vogël.

Inspektimi higjienik sanitar është 00 përse është 00, a e inspekton inspektoriat institucionet publike apo dhe ato private a dhuron ndonjë gjobë për ato?

Të hyrat nga agjencioni pyjor këtu mos të flasim është zero gjithë, është shqetësuese kjo kategori.

Shpenzim udhëtim jashtë vendit në vitin 2022 ka qenë 120.00E, ndërsa tani është 5,981.25E është shumëfishim në këtë kategori shpenzimi i buxhetit.

Shpenzimet e telefonisë mobile, 0 ka qenë në vitin 2022, ndërsa tani është 6,000.00E.

Shpenzime për anëtarësim 3,500.00E i kemi pasur në vitin 2022, ndërsa tani janë 21,630.00E.

Shërbime të ndryshme intelektuale 53,350.00E me 11,040.00E në raport me vitin 2022 është shumë e lartë.

Shërbimet e arsimit, trajnimit në vitin 2022 990.00E, ndërsa tani 3,705.00E.

Shërbimet kontraktuese të tjera 480,464.11E me 177,338.14E në raport me vitin e kaluar.

Pastaj kemi paisje mjekësore në vitin 2022 kemi pasur 0, ndërsa tani kemi 30,000.00E.

Kompjuter në vitin 2022 kanë qenë 979.00E ndërsa tani 26,768.00E.

Paisje trafiku 0 ka qenë në vitin 2022, ndërsa tani 15,000.00E. Furnizime zyre 19,955.00E në vitin 2022 ndërsa tani 33,696.37E.

Avans për udhëtime zyrtare e kemi 10,361.00E, nuk e di për qfar udhëtime zyrtare përveq vetëm një udhëtimi zyrtar që ka pasur Kryetari në SHBA.

Dru në vitin 2022 kanë qenë 120,775.46E ndërsa tani 201,252.44E.

Gas natyror 0 vitin e kaluar, ndërsa tani 10,000.00E.

Mirëmbajtje dhe riparimi i automjeteve 16,108.00E.

Mirëmbajtja e mobilie dhe paisjeve është 30,000.00E është shumëfishim i kësaj shume. Mirëmbajtje rutinore nga 850.02E në 26,541.70E.

Dreka zyrtare nga 7,012.20E është rrit në 12,141.00E.

Janë një mori kategorish që janë shumëfishim i ngritjes kishte qenë mirë që Drejtori me na dhënë një sqarim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Sylë Dukolli!

Sylë Dukolli: Veton, agjensioni i pyjeve është i pavarur ka mjete të cilat i marrin ata por ato shkojnë direkt në agjension të pyjeve. Ata është dashur të i kthejnë por ligji ka kaluar dhe shkojnë direkt në agjension të pyjeve.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Faleminderit drejtor për prezantimin e raportit, meqenëse këto periudhat e raportimit janë të rregulluara me ligj secila organizat buxhetore është e obliguar të ja paraqes kuvendit raportet. Ajo çka e dallon komunën tonë, është mënyra e përpilimit të raporteve dhe detajet të cilat i përmbahen këtyre raporteve që është për duartrokitje, sepse më ka ra rasti me i pa raportet e organizatave të tjera të cilat janë shumë të ngjeshura në kuptimin janë shumë pak të detajizuara.

Ajo që vlenë të theksohet në kuadër të këtij raporti gjashtë mujorsh është niveli i shpenzimit të buxhetit ku në total është tejkaluar mbi 11% nëse e ndajm në periudha të barabarta çdo tre mujorsh, pra në dy periudha komuna ka arrit me realizu dhe me tejkaluar buxhetin. Ajo çka më bëri përshtypje dhe si ka pasur mundësi me ndodh është te kategoria e pagave ku thot që është shpenzuar buxheti 55%, në rast se i njëjti numër i të punësuarve është dhe në periudhën e dytë i bie 45% kjo kategori e pagave është e pa mbuluar në kontekstin e pagave. Përse ka ndodhur kjo, a ka ndodhur për arsye të vendimeve gjyqësore dhe a keni ndonjë zotim që ka me i mbulu qeveria në fund të vitit që puntorët publik në fund mos të mbeten pa paga.

Sa i përket të hyrave vetanake në radh të parë i falenderoj qytetarët të cilët janë të përgjegjshëm ndaj obligimeve të cilat i kanë, mbi 165.000.00E ka më shumë pagesa të tatimit në pronë se në vitin paraprak. që është për duartrokitje sepse i kanë përmbush detyrimet e tyre.

E dyta ajo çka ishte më e frikësuar ishte lejet ndërtimore, afër 150,000.00E ka më shumë leje ndërtimore të këtij viti në raport me vitin paraprak dhe është e mirë kjo.

Sa i përket disa pyetjeve të cilat i bëri Vetoni nganjëherë janë gabimet teknike gjatë procesimit të të dhënave në SIMFK, sepse të gjitha certifikatat të cilat nxirren e kanë nga një lloj të ndryshëm sepse është një aktivitet në veti, mirëpo gjatë procesimit në sistem ato futen si të përbashkëta për arsye të ngarkesës së njëjti të cilat ato e posedojnë. Kjo mundet me zbeh raportin por aspak nuk është në dëm të buxhetit të Komunës së Malishevës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Faleminderit Vetonit dhe Valonit, siq e cekim dhe Vetoni në KPF i kemi cekë disa qështje por të i sqarojm dhe për asambleist të tjerë.

Te qështja e të hyrave vetanake dhe qertifikatat ne kemi diskutuar dhe me administratën por qertifikatat e lindjes dhe të vdekjes kategorizohen te qertifikata e tjera. E kanë marrë si praktik dhe të hyrat krijohen nga kjo pjesë përveq qertifikatat nga kunorizimi.

Taksat Komunale të ushtrimit të veprimtaris disa biznese janë të ngarkuara me këtë taks.

Shfrytëzimi i pronës publike nëse thirresh në atë që është në disproporcion me 50% më pak në periudhën 6 mujore, ju njoftoj se në korrik është përfunduar dhe pjesa e dytë e shpenzimit të pronës bazeni në Banjë që është në vlerën 8,000.00E, nëse do të kishte hyrë në këtë pjesë të raportit do të ishte e njëjta.

Pranim teknik të lokaleve nuk kam, nuk e di zyra e inspektoriatit a ka inxhinier të ndërtimi dhe a i zhvillojn procedurat e pranimit teknik nga Komuna. Ndërsa te pjesa e realizimit të shpenzimit po përgjigjja te pyetja e Valonit që e cekim a është realizuar shpenzimi i kategoris së pagave 55%, është e vërtet që këtu po flitet për shpenzim, dhe për përqindje të shpenzimit është pjesa e kategoris që është marrë nga vendimet gjyqësore për pagesat e mësimdhënësve, mirëpo si vitin e kaluar dhe tani është e mirë që këto vendime gjyqësore të mirren nga kategoria e pagave dhe nga kategorit e tjera që në fund të vitit nuk do të mbetet pa u paguar asnjë pagë. E kemi dhe një pjesë të kësaj periudhe pagat dhe mëditjet që jan sufidid, është qështja e puntorëve në qerdhe që ka qenë e planifikuar për 20 punëtor të paguhen deri në këtë muaj dhe ajo pjesë është e pa shpenzuar, pjesa e periudhës parë ka qenë e pa shfrytëzuar.

Vetë fakti i ngritjes së buxhetit nënkupton dhe ngritja e shpenzimeve se viti i kaluar, periudha e shpenzimit dallon dhe për një arsye tjetër sepse kemi pasur disa obligime të vitit të kaluar, gjithashtu shumë shërbime në këtë periudh jan përfunduar më shumë se që jan planifikuar.

Shpenzimet të udhëtimeve jashtë vendit, është e vërtet që kemi pasur zyrtarisht udhëtime jashtë vendit ju kam njoftuar dhe në Komitet që përveq vizitës që e kemi pasur në Neë York, Kryetari ka pasur dhe dy

vizita tjera me zyrtarët Komunal jashtë vendit njëra në Austri nga Kryetari dhe njëra nga Drejtoria e shërbimeve publike në Japoni të cilët kanë pasur një trajnim për menagjimin e mbeturinave . Shërbime kontraktuese të tjera janë disa operator të cilët kryejn veprimtarinë e ushtrimit të tyre siq është në shëndetësi, është dhe në Kuvend Komunal dhe paguhen nga mallra dhe shërbime. Paisje mjekësore është një gjë që nevojat shëndetësore kryhen dhe në shërbime specialistike mjekësore. Kompjuterët ju e dini se dhe administrata dhe Kuvendi Komunal janë furnizuar me kompjuter. Furnizime të zyrës dhe pse është bërë një shpenzim i tillë prap ka nevojë për furnizime të zyreve, sepse këtë vit kemi pasur vështirësi për materialin e zyreve për arsye se është një operator i kontraktuar nga niveli qendror dhe nuk mund ta diktojm atë operator me furnizim të kënaqshëm. Dru dhe pse ka qenë qmimi më i lartë një pjesë e kategorisë së shpenzimeve për furnizim të fund vitit 2022 është përfunduar pagesa në periudhën 6 mujore të këtij viti. Karburantët dhe këtu është ndikimi i qmimit është pak më e ulët por është qështje e lëvizjes së qmimit. Mirëmbajtja teknike e automjeteve kjo nuk varet nga planifikimi i shpenzimit por varet nga mirëmbajtja dhe gjendja teknike e automjeteve. Inventarizim me mobilie dhe paisje të tjera, sipas nevojave janë përfunduar realizimi i inventarizimit janë përfunduar dhe shpenzimet. Drekat zyrtare nuk i kemi cekur, sepse këtë vit kemi pasur disa duke përfshirë ditët festive siq është Shkurti, Marsi, Qershori dhe kanë bërë që të jetë një shpenzim i tillë.

Argjend Thaçi: Me kaq e mbylli debatin për këtë pikë të rendit të ditës, duke vazhduar me pikën e radhës e cila është:

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/317 datë: 22.06.2023 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënie në shfrytëzim të pronës shoqërore Komunale dhe për realizimin e projekteve të KEDS-it për zgjerimin dhe përfortimin e ambientit të shpërndarjes së ndërtimit të trafo-stacioneve për regionin e Komunës së Malishevës. Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Ne në parim jemi për me përkrah këtë kërkesë, sepse të gjithë ne jemi duke e parë se sa e domosdoshme është investimi në KEDS sidomos në ndryshimin e rrjetit. Ne me votë po por nuk kalon, sepse këto prona janë prona publike të cilat ndoshta dhe kanë qenë në listën fillestare për dhënie në shfrytëzim të pronës publike dhe që opozita nuk e ka votuar atëherë. Ne mundemi me votë po por është e pamundur, sepse e ke ndaluar një proces në gjysmë. Çdo pronë publike fillimisht kur dhurohet në shfrytëzim duhet me u bërë miratimi i listës paraprake, me u miratu në kuvend me shku në agjension kadastral. Me pasur një akt preliminar cilat prona kanë me u dhënë në shfrytëzim pastaj secila me u trajtuar ndaras.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Burim Paqarizi!

Burim Paqarizi: Përsëndetje për të gjithë!

Unë e kam parë këtë kërkesë të Kryetarit dhe e dimë të gjithë që është shumë e nevojshme që investimet e KEDS-it të jenë në Komunën tonë. Besoj që Kryetari dhe stafi do të dhurojnë presionin më të madhë për ndërtimin e trafo-stacionit, për 110kV që të i furnizoj në mënyrë sa më të mirë qytetarët e Komunës së Malishevës me energji elektrike. Mirëpo dhe dhënia në shfrytëzim të pronës janë perimetra të specifikuar, secili pozicion besoj që shumica prej tyre ka qenë në trafa ekzistuese ku kanë qenë dy apo tri metra katror, me u bërë 7m2 dhe me leju ndërtimin e një trafo moderne për shërbim dhe nevojat e qytetarëve. Ne si Parti Demokratike i përkrahim investimet e KEDS-it dhe furnizimet më të mira me energji elektrike. Ne e përkrahim si pikë të rendit të ditës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina: Përsëndetje për të gjithë!

Valoni ka të drejt kur thotë që nuk është në atë listën e miratuar paraprakisht. Valon meqë janë sektore të rëndësishme së veçantë ligji ja lejon dhe procedurën e konkureshmërisë, sepse nëse e merr një pronë në

shfrytëzim vendoset në ankand dhe në procedur afatgjate duhet konkurenca me u pa. Në rastin konkret nuk ka konkurenc, ligji e përjashton për arsye se KEDS-i ka me marrë i vetëm. Kërkesën e ka përgadit Valmiri, aty është një mangësi të cilën duhet me plotësu ju tani për arsye se duhet me u caktu sa do të jetë metra katror. Nuk besoj që Ministria e pushtetit lokal do ta shtyjë për arsye se nuk është në atë listën e miratuar paraprakisht, sepse Ministria dhe as Komuna nuk mundet me i ditë planet e KEDS-it, ka mundur me u miratu ajo listë por trafat ekzistuese mos me qenë në listë të parashikuar. Ajo çka mungon që është thelbësore në këtë kërkes është caktimi i vlerës për m2, ne po ja dhëjmë në shfrytëzim por sa do të kushtoj kostoja për m2.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Nuk më është kujtuar përjashtimi i konkurrencës, është logjike kur nuk ka konkurenc të asaj fushe. Uroj me qenë kështu dhe të miratohet, me rëndësi për ne është që investimet mos të ndalen sepse interesi i qytetarëve është më i madh se sa i një grupi të caktuar të individëve. Mesazhi im ishte që nga një vendim i sodit diktohen shumë vendime në të ardhmen, për këtë arsye duhet me qenë shumë i arsyeshëm kur e merr një vendim dhe me planifiku cilat janë efektet anësore të cilat mundën me u ndiku nga ky vendim.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Dilema a do kalojë nga MAPL ky vendim, e kam sqaruar pak nga momenti kur Muharremi e ka ngritur si qeshje në KPF dhe sqarimet që i kam marrur nga Muharremi, i kam marrur dhe nga zyrtarët ligjor. Është e pamundur që në atë listën e pronave me ditë se në cilën pronë do të vendoset trafostacioni. Ka këso përjashtimesh ligjore që bëhen, por besoj që nuk kthehet i jashtëligjshëm. Valon kur të bëshë një kritik duhet të bësh shumë korrekt, sepse nuk është opozita që e ka bllokuar për mos me kalu ajo pikë. Krejt qka kemi kërkuar atëherë, ka qenë që me pas një pasqyre më të qartë për secilën pronë jo vetëm numra dhe shifra. Mua më ka interesuar për secilin numër që e kam parë në atë listë me na tregu Drejtori i Kadastrit se ku gjindet ajo pronë, në Lladroc e shohë një shifër por nuk e di ku është ajo pronë. Kur i kam kërkuar këto sqarime a është në gjendje nga kjo datë deri në datën tjetër, një muaj ditë me na sjellë, e ka sjellë prapë listën e njejtë dhe për këtë arsye vota jonë ka qenë kundër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne jemi dëshmitar që në komunën tonë përballemi me shumë sfida sa i përket energjis elektrike, kemi një rrjet elektrik të dëmtuar dhe trafo të vjetra, të gjitha këto ndikojn në furnizimin me energji elektrike. Ne pa dyshim që vota jonë është pro këti vendimi por siç i potencuan Valoni dhe Muharremi disa problematika për arsye të një vendimi të ma hershëm. Ne nuk kemi fare listë të pronave të cilat kan me u dhënë në shfrytëzim për vitin 2023. Për këtë arsye që nuk kemi listë mundet me na u shkaktu një problematik në raport me këtë. Ne jemi pro e këti vendimi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Arlind Morina!

Arlind Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Ne të gjithë e dimë se sa e nevojshme është kjo kërkes, kur e dimë që si komunë përballemi me ndërprerje të mëdha të energjisë elektrike. Një kërkes e tillë ne realizim do të ishte e mirë për të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës, jo vetëm gjatë sezonit dimëror por gjatë gjithë stinëve. Vetëm në këtë muaj paralajmrimet kanë qenë që Komuna e Malishevës do të ketë ndërprerje të energjis elektrike me nga 6 orë, kjo për të gjithë bizneset dhe qytetarët e Komunës së Malishevës është një problematik shumë e madhe. Ne si grup në emër të LDK-së e mbështesim fuqishëm këtë kërkes dhe shpresojm që kjo kërkes të gjejë zbatim sa më shpejt.

Argjend Thaçi: E hedhi në votim, kush është për miratimin e kërkesës nr. 02/317 datë: 22.06.2023 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënie në shfrytëzim të pronës shoqërore Komunale dhe për

realizimin e projekteve të KEDS-it për zgjerimin dhe përforcimin e ambientit të shpërndarjes së ndërtimit të trafo-stacioneve për regjionin e Komunës së Malishevës.

Me vota unanime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

18 anëtarë jemi të pranishëm dhe kemi kuorum të vazhdojmë punimet e kësaj seance.

Vazhdojmë me pikën e radhës e cila është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/271 datë:31.05.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike. Është e njëjtja kërkesë siq ke ajo e më parshmeja së pari shpallja e zonës në interes publik pastaj për këmbim të pronës.

Kush është për shpallje të zonës në interes publik?

Për: 14

Kundër: 0

Abstenim:

Veton Zogaj: Ne nuk kemi në dijeni për cilën pikë po bëhet fjalë, për këtë pikë e lirojmë sallën.

Argjend Thaçi: Ne materialin ju kemi dërguar më herët dhe nuk është mirë me ndal procesin e votimit në gjysmë secili mundemi me qenë kontribues pozitiv dhe negativ në secilën qështje që diskutohet dhe debatohet në Kuvend.

Sallën lëshon grupi nga VV, nga LDK-ja Labinot Gashi dhe Adile Hoxha.

A kemi kuorum?

Për mungesë të kuorumit ndërprehet seanca.

Kolegë po rikthehemi dhe një herë të pika e 4, sepse nuk ja kemi vendosur tarifën për dhënjën në shfrytëzim të pronës KEDS-it. A ka propozime? Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Unë propozoj që kjo tarifë duke marrë parasysh që prej kohës kur e citoj Muharremi më herët që janë 3 ose 4 vite, kërkoj që të jenë 10E për metër katror.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Pajtohem me Valonin që shuma të jetë 10E për metër katror, por a është mujore apo vjetore kjo shifër.

Muharrem Morina: Është vjetore.

Halil Morina: Kjo është shumë e papërfillshme, duhet të mendojmë ndonjë tarifë tjetër.

Muharrem Morina: Halil ke qenë pjesë e mandatit të kaluar anëtarë dhe kur i kemi ngarkuar me një shumë tjetër ata kanë hekur dorë për arsye se kanë thënë që nuk mundën me përballu sepse është për 99 vite. Pastaj e kemi dërguar vendimin në rishqyrtim dhe e kemi ulur në një vlerë.

Halil Morina: Unë mendoj që është shifër e papërbalueshme për KEDS-in, nëse ka ndonjë propozim Drejtori i Financave.

Blerim Thaçi: Unë mendoj që rrebas disa vite siç është 99 vite mundet me i ra vlera kësaj shume, nuk e di a mundet me ju vendos një taksë në një periudhë më të shkurtër.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Është e vërtetë se për jetëgjatësinë e kësaj kontrate vlera 10E mund të devalvohet por mund edhe të rivlersohet varësisht prej kësaj. Por interesi ynë është që të përfundoj ky investim, unë kisha konsideruar që 10E është e mjaftueshme, ne jemi prap këtu dhe mund ta harmonizojmë pak a shumë me ngarkesën për taksë kur i bëhet këtyre institucioneve me bërë një bilanci të gjendjes.

Muharrem Morina: Dy qështje duhet me i ditë Valon, e para është pronësia dhe pronari i ri i cili do ta blejë KEDS-in në të ardhmen ka me pasur negocjim të ri me Komunën, ne në kontrat duhet me i definu këto gjëra. Meqë është energji elektrike dhe energjia elektrike është sektor me rëndësi vitale për shtetin me ligj shteti e ndihmon, në këtë rast Komuna e ndihmon operatorin me ofru energji për të gjithë. Për vitet mundeni me vendos ju unë e ceka maksimumi mundeni 99 vite për arsye se pronësia nuk bartet, por ju mundeni me bërë 50 vite dhe me këtë tarif gjeneratat të cilat vinë munden me rishiku këtë kontrat.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Alban Kastrati!

Alban Kastrati: Po ndërlihdna te tarifa, ne me dëshir ja kishim caktu 100E por po frigohemi siq e ceki dhe Muharremi si investitor. Besoj që kishte me qenë mjaft nga 5E me ngrit në 10E.

Muharrem Morina: Nuk e di a e keni dhe kërkesën e KEDS-it sipas kësaj ka 9m2, 18m2 kjo është një e hyrë vjetore e Komunës jo e vogël. Investimi që parashihet është në shërbim të qytetarëve dhe tonin si institucion vitet i caktoni ju dhe pastaj kjo shkon në procedur. Me rëndësi është që kan të drejtën e shfrytëzimit dhe pronësia nuk ju bartet.

Argjend Thaçi: Kush është që tarifa prej 10E për m2 vjetore të jetë për dhënie në shfrytëzim pronën publike KEDS-it në kohë afat gjate prej 50 viteve, kush është për?

Me vota unanime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë te pika e 5 Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/271 datë:31.05.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike. Te kjo pikë e keni materialin, plotësimin e dokumentacionit nga dy seancat e kaluara. A ka dikush debat për këtë pikë?

Urdhëro, Veton Zogaj!

Veton Zogaj: Unë dhe në KPF e kam kundërshtuar këtë kërkesë, jo që kam diqka personale me Enverin por si kërkesë e kemi trajtuar në seancën më herët dhe kemi marrë një vendim. Nëse ne krijojmë si president të ri dhe miratojmë kërkesën e Enverit çdo herë kemi me pas kërkesa të shumta të këti lloji. Përveq që e votojmë kundër, ne nuk marrim pjesë në votim për këtë pikë.

Argjend Thaçi: Urdhëro Alban!

Alban Kastrati: Edhe unë i bashkangjitem vendimit të Vetonit, pra nuk qëndrojm në votim për këtë pikë.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Labinot Gashi!

Labinot Gashi: Nëse më kujtohet në seancën e kaluar Muharremi e ka cekur që nuk kemi të drejtë ligjore me bërë një gjë të tillë, për arsye se ndërrimi i pronës bëhet në zonën e njëjt dhe kjo është ajo që e sqaroj dhe Vetoni. Muharrem këtë sqarim e kemi marrë në seancën e kaluar, te qështja e pronave duhet të kemi kujdes sepse qytetarët duhet të trajtohen njëjt.

Muharrem Morina: Labinot, po më vjen keq por në këtë pikë në seancën e kaluar nuk e kam marrë fjalën fare, njëher që është shqyrtuar kjo kam thënë që pa kërkesë nuk bënë. Qështjen si e vendosni është qështje e juaja, në aspektin ligjor pala ka të drejtë sa herë të ka mundësi me parashtru kërkesë për me realizu një interes të vetin. Në varet nga ju a e shqyrtoni e aprovoni apo a e shqyrtoni refuzoni.

Argjend Thaçi: Atëherë e vendosim në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Sallën e liruan VV-ja: Veton Zogaj, Agnesa Kastrati, Arbnore Hoti, PDK: Alban Kastrati, Burim Paqarizi, Arlindë Rudi, dhe nga LDK: Labinot Gashi, Adile Hoxha.

Argjend Thaçi: A kemi kuorum?

Në mungesë të korumit vetëm 14 anëtarë jemi prezent nuk kemi kushte për vazhdim të punimeve, shtyhet seanca.

Vazhdojmë pas një pushimi për arsye të mungesës së korumit mbledhja shtyhet, për vazhdim të kësaj mbledhje ju njoftojmë në ditët në vazhdim.

Vazhdimi i mbledhjes së -IV- gjashtë të Kuvendit Komunal të Malishevës, datë: 14.08.2023, ora: 10:15.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë!

Mirë se keni ardhur në vazhdimin e seancës të mbledhjes së gjashtë, të pranishëm në mbledhje jemi 17 anëtarë kemi korum për vazhdim të mbledhjes.

Pika e radhës është: 5.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/271 datë:31.05.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike.

Nëse nuk ka dikush për debat e hedhim në votim, kush është për miratimin e kërkesës nr.02/271 datë:31.05.2023, e parashtruar nga Enver Mazreku për këmbim të pronës private me pronë publike.

Së pari kush është për të shpallet zonë e lirë?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 15 vota për, asnjë kundër, 2abstenime shpallet zonë e lirë.

E hedhim në votim për këmbim të pronës kush është për?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 2

Me 15 vota për, asnjë kundër, 2 abstenime miratohet këmbimi i pronës.

Pika e radhës është: 6.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.04/382 datë:21.06.2023, për Ridestinimin e mjeteve për investime kapitale.

Nëse nuk ka debat për këtë pikë e hedhi në miratim kush është për miratimin e kësaj kërkesë?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 17 vota për, asnjë kundër, 1abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Argjend Thaçi: Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/940 datë:05.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë privat, për interes publik, me rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në qytezën e Malishevës.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë!

Në komunën tonë janë duke u bërë dy projekte shumë të mëdha dhe shumë të rëndësishme. Çdo këmbim

prone private me atë publike që është në interes të këtyre dy projektëve gjithë her e ka votën e grupit të NISMËS.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina: Përsëritet për të gjithë!

Qështja te këmbimi që po kërkohet sipas kërkesës së Kryetarit, realisht është një interes i veçant dhe ata të cilët jetojnë në Malishevë e dinë më mirë. Mirëpo zona për të cilën po flitet është zonë në qendër të qytetit të ura, është një sipërfaqe shumë e vogël mirëpo pa e këmbi nuk kemi mundësi tjetër me përfund. Procesi mundet me ndiku për arsye se zona të cilën pala e ka kërkuar është pronë e ujrave, është pronë shoqërore e ujrave dhe në këtë procedur vendimi i asambles do të shkojë në Ministri për konfirm të ligjshmëris pastaj shkonë në vlersim. Ju e shihni që jan 5m2 dhe 5m2 që janë ofruar, asnjë ari as nuk i merret dhe as nuk i dhurohet, mirëpo mbi të gjitha kjo shkonë me metër2 në bazë të vlersimit të cilin e jep Ministria. Është një pjesë shumë e vogël e tokës por palës i konvenon sepse ja kemi marrë një pjesë të vogël të tokës dhe ai dëshiron me këmbi me pronë publike.

Argjend Thaçi: Nëse nuk ka dikush tjetër për diskutim e hedhim në votim kush është për miratimin e kërkesës nr.01/940 datë:05.07.2023, e parashtruar nga Kryetari i Komunës për ndërrimin e pronës publike me pronë privat, për interes publik, me rastin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore në qytezën e Malishevës.

Unanimisht miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrtat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022.

Nga zyra e auditorëve nuk e kemi prezent askënd a ka dikush diskutim apo debat për këtë pikë të rendit të ditës.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne e kemi bërë që nëse nuk është përfaqësuesi zyrtar përkatës për prezantim të asaj pike të shtyhet, kështu që është mirë të shtyhet për seancën e radhës.

Argjend Thaçi: Një zyrtar qenka duke ardhur për prezantim të kësaj pike, e presim pak.

Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Unë propozoj siq propozoj dhe Halili që pika e 8 dhe pika e 9 të shtyhen pamvarësisht a vjen apo jo zyrtari, nëse ai e ka ditur që është raporti është dashur me qenë në Kuvend.

Argjend Thaçi: Kush është për shtyrje të pikës së 8. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditimit për pasqyrtat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022 dhe pikës 9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimt për zbatimin e rekomandimeve, sipas rekomandimit të zyrës Kombëtare të Republikë së Kosovës për të gjeturat e vitit 2022.

Me vota unanime shtyhen këto dy pika për mbledhjen e ardhshme.

Pika e 10-të është: Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor i Drejtorisë për Bujqësi për vitin 2023. Nga Drejtoria për Bujqësi nuk e kemi askënd për ta prezantuar këtë pikë të rendit të ditës, kush është që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës?

Unanimisht shtyhet kjo pikë e rendit të ditës. 19 anëtarë jemi prezent.

Pika e radhës është: 11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 02/202, datë: 14.04.2023, e parashtruar nga Driton Krasniqi. Kemi të bëjmë me një kërkesë për dhënjën e pëlqimit për ndërtimi e një lapidari për prindërit e vetë në fshatin Tërpez.

Urdhëro, Muharrem Morina!

Muharrem Morina: Është një kërkesë e një qytetari në fshatin Tërpez i cili dëshiron me ndërtu një amfiteatër të vogël me një vul që e simbolizon emrin e tij dhe për arsye se prindi i tij ka qenë arsimtarë në shkollë. Dhe më herët ka qenë një kërkesë e tillë dhe kam menduar që i keni dhënë pëlqim për me vendos Lapidarin aty. Në konstatim dhe me kolegën e juaj këtu ne mundemi me marr dhe me ja dhënë në shfrytëzim, sepse dhënja në shfrytëzim i ka procedurat e veta, shkon në asamble, nga asamblea në ministri dhe ministria prapë kërkon me zbatu ligjin që jemi të obliguar dhe ne. Kem ardhur në përfundim që për me pasur të drejtë ai me investu aty, për me bërë një lloj amfiteatri që është publik, pronësia nuk preket mbetet në emër të Kuvendit komunal. Amfiteatri është i hapur dhe e ka një guri i cili shenon fjalë për arsimtarin e ndërës. E vetmja formë që me kalu dhe me pasur pronësinë tonë dhe me pasur qasje gjithë komiteti aty është një lloj pëlqimi që komuna e lëshon për me bërë një investim të tillë, por pëlqimi nuk shkon në ministri që të merr konfirmim të ligjshmërisë. Komuna e regjistron atë në kataster si pronë të vetën, është i hapur për vizitorë. Këshilla ime ka qenë që ti japim një pëlqim, jo vendim sepse vendimi shkakton pasoja tjera të cilat ne nuk mundemi me i kalu. Pëlqimin e merr dhe ai investimin e përfundon dhe është pronë publike e hapur për vizitorë dhe nuk do të ketë asnjë telashe.

Argjend Thaçi:Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Faleminderit Muharremi për sqarimet që na i dha, meqë me një hapsir publike po dëshiron me ndërtu diqka për qëllime publike jo për përdorim privat dhe është një qështje e ndjeshme, pra qështja e një dëshmorit të vrar në luftë, besoj që është legjitime dhe kërkesë morale e jona që me ja dhënë një pëlqim kur e dim që në atë vend nuk pengon asgjë dhe nuk prish asnjë plan të komunës për ndonjë ndërtim apo ndonjë gjë tjetër. Kështu që përse mos me u bërë një amfiteatër që është për interesa publike. Ne jemi pro e këti pëlqimi.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesa Kastrati!

Agnesa Kastrati: Të nderuar kolegë asambleist, dhe unë mendoj që është mirë me votu këtë pikë, por vetëm ajo qka dëshirova me thënë është që ne duhet me u kujdes që kjo të mbetet hapsir publike mos të kaloj në pronësi individuale. Amfiteatri është një ide shumë e mirë dhe shfrytëzohet për interesin publik.

Argjend Thaçi: Konstatoj që 19 anëtarë jemi prezent, nëse nuk ka askush tjetër për diskutim, e hedhim në votim kërkesës nr. 02/202, datë: 14.04.2023, e parashtruar nga Driton Krasniqi. Kush është për miratim të kësaj kërkesë?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 18 vota për, asnjë kundër, 1 abstenim miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: 12.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/385 datë:14.03.2023, e parashtruar nga Adem Hoti. Është një kërkesë që është ardhur dhe nga ish kryesia e fshatit i cili ka kërkuar një lokacion, një pronë publike për ndërtimin e shtëpis nga kërkesat të cilat i kan ardhur nga donatorët e ndryshëm. Kushtet dhe kriteret nga donatorët kan qenë që trualli me qenë në emër të tij dhe ky ka paraqitur kërkesën. Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Kjo është një qështje e ndjeshme, personi që po dëshiron me ndërtu një shtëpi apo shoqata humanitare e cila po dëshiron me ja ndërtuar një shtëpi ai nuk ka as 1m2 pronë të tij. Për me fitu këtë lloj donacioni i cili bëhet fjal për shoqatën Jetimat e Ballkanit, atëherë nëse ligjërisht jemi në rregull unë kisha thënë ne me ja dhënë këtë hapsir sepse nuk është që e dëmton interesin publik, por vetëm ja zgjidhim një problem të madhë një qytetari.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Ne patjetër që i kemi në konsiderat kushtet e tij që me domosdoshmëri me pas një shtëpi, një pronë me ndërtuar shtëpin. Moralisht jemi të gjithë të pajtimit me ja bërë një zgjidhje, por në aspektin procedural si ka mundësi me ndodhë kjo unë nuk e kam të qartë. Nuk mundemi me këmbë, vetëm duhet me ja dhënë në shfrytëzim, për me e dhënë në shfrytëzim duhen disa procedura të cilat ekzekutivi i dinë shumë mirë. Është mirë me trajtu këtë temë më gjerësisht, ose është qendra për banim social mos me lënë pa shtëpi, por me dhënë pronën publike jan disa procedura.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati: Unë i kam disa pyetje sepse dhe për mua është e pa qartë meqenëse në kërkesë është e cekur që ai aktualisht jeton në këtë lokacionin të cilin e dëshiron. A ka shtëpi ai në atë pronë publike? Unë nuk e di nëse e kemi votuar një diçka të tillë, sigurisht që jam me i mbështet qytetarët e Malishevës dhe normalisht një rast të tillë të ndjeshëm është mirë me i ndihmu. Por qfarë bëjmë ne nëse na dyfishohen këto kërkesa sepse ne e dimë që nuk jan këto raste individuale, raste të skamorëve ka shumë në Malishevë, ka dhe familjarë të tjerë të cilët gjejnë ndihmë por nuk kan truall për të ndërtuar shtëpin. A kemi mundësi ne me i dhënë të gjithëve?

Argjend Thaçi: Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Në secilin fshat ka ndonjë familje që nuk ka pasur pronë me ndërtuar shtëpin dhe janë mbledhur fshatarët i kan thënë që po ta ndërtojm këtu në hajrat, dhe ky rasti është i njëjt. Valoni e ceki banimi social, por nëse kemi mundësi ligjore me ja lënë një lokacion përse me ja nxën diku tjetër banimin. Nuk e di nëse është e mundur me ja dhënë në shfrytëzim afat gjatë për 99 vite, dhe me ja vendos një qira të papërfillshme sa mos me i ik donacioni. Muharrem a ka ndonjë zgjidhje.

Muharrem Morina: Me ligj janë dy mundësi këmbim dhe dhënie në shfrytëzim, me dhënë në shfrytëzim siq e ceke ti nuk mundesh për arsye se një vitë para është dashur me qit me atë vendimin që neve na kanë refuzu. Këmbim pala nuk na ka ofru asgjë me këmbë, ai është dashur një pronë private e cila ka qasje në pronën publike me dhënë në këmbim për me marrë atë pronë.

Halil Morina: Ai nuk ka asnjë pronë, sepse e kish ndërtuar shtëpin në pronë të tij.

Muharrem Morina: Ju mundeni me vendos në bazë të kërkesës por duheni me i dhënë bazë ligjore përndryshe ai vendim nuk miratohet.

Argjend Thaçi: Atëherë po e shtyjme këtë kërkesë derisa të gjejmë një zgjidhje, kush është për shtyrjen e kërkesë nr.01/385 datë:14.03.2023, e parashtruar nga Adem Hoti?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 1

Me 16 vota për, asnjë kundër, labstenim shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e radhës është: 13.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/637 datë:22.12.2022, e parashtruar nga Arijon Krasniqi, dhe kjo është kërkesë e njëjt.

Urdhëro Halil Morina!

Halil Morina: Është natyra pothuajse e njëjt, rasti është më i ndjeshëm se sa rasti i parë. Arjoni është pa dy duart dhe kishte qenë mirë me i ndihmu ati personi dhe ja vlenë me gjetë një mundësi sesi me ja bërë.

Argjend Thaçi: Dhe kjo kërkesë është për ndarje të pronës, nuk ka të bëjë as me këmbim, as me dhënie në shfrytëzim. Është e njëjt si kërkesa e parë, kush është që kjo kërkesë nr.02/637 datë:22.12.2022, e parashtruar nga Arijon Krasniqi, të shtyhet për një seancë tjetër? Unanimisht shtyhet kjo kërkesë. 18 anëtarë jemi të pranishëm.

Pika e radhës është: 14.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/199 datë: 06.04.2023, e parashtruar nga Luljeta Telaku. Është një kërkesë që është bërë më herët por për arsye të shtyrjes së seancave ka mbetë deri më tani.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne kemi bërë vërejtje për me gjet formë për këto rastet që po janë me sëmundje, dhe kësi raste të karakterit kulturor artistik Komuna e Malishevës përkatësisht Drejtoria e Kulturës qdo vit ka konkurse që aplikojnë shoqata të ndryshme, shkrimtar, sport, kultur, muzik, art dhe të tjera. Kisha thënë që kur të vjen koha e aplikimit kush do që ka kësi lloj aktiviteti të financohet dhe subvencionohet përmes Drejtorisë së Kulturës dhe mos ta bëjmë në të dy anët me u subvencionu. Unë jam kundër që në këtu të ndajmë mjete për derisa ndan Drejtoria e Kulturës.

Argjend Thaçi: Urdhëro, Agnesë Kastrati!

Agnesë Kastrati: Ajo çka dëshirova me cekë është që Luljeta e ka promovuar librin, sepse e ka pasur me 16 Qërshor, kërkesa na ka ardhur disa seanca radhazi. Kërkesa të tilla për me u subvencionu në Kuvend do të duhej të kalonin në ndonjë komision sepse Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ndan mjete financiare për mbështetje të iniciativave të kësaj natyre. Komision që e vlerëson se çka është ky libër, si është i shënuar ky libër, a ja vlenë me u votu ky libër sepse jo çdo libër ja vlenë me u botu. Unë mendoj që nuk duhet me mbështetë këtë kërkesë, më vjen keq që kjo është grua dhe ndoshta e ka bërë një punë të mirë në librin e saj, nuk dua me paragjyku por pa kaluar ky libër së paku në një Komision që së paku e verifikon se qfarë libri është.

Argjend Thaçi: 16 anëtar jemi prezent kemi kuorum, kush është për miratim të kërkesës nr.02/199 datë: 06.04.2023, e parashtruar nga Luljeta Telaku?

Për: 9

Kundër: 6

Abstenim: 1

Me 9 vota Për, 6kundër, 1abstenim miratohet kjo kërkesë.

Kalojmë te ndihmat momentale janë gjashtë kërkesa të natyrës së njëjtë unë kisha propozuar që këto të i mbështesim nga 1,500.00E dhe votimi të bëhet një nga një, a jeni të pajtimit për këtë shumë.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne e kemi Drejtorin e Financave këtu dhe kisha thënë mos të ndajmë shifra, dhe qytetari me u gëzu që ja kemi nda një shifër, pastaj mos me dit kur po i del ajo shifër për arsye të mungesës së mjeteve. Kisha kërkuar një sqarim për mundësit financiare nga Drejtori dhe në bazë të rekomandimit të ti me ju ndihmu.

Argjend Thaçi: Pasi që nuk kemi nda mjete tre muaj besoj që duhet të ketë mjete.

Urdhëro, Blerim Thaçi!

Blerim Thaçi: Mjetet për subvencionim janë pothuajse në përfundim, duke i pasur parasysht subvencionimet që i kemi në bujqësi, pastaj i kemi ekzekutuar subvencionet në kulturë, te kryetari veqse kanë përfunduar.Ndihmat momentale janë qështje të ndjeshme prandaj kisha kërkuar që të keni parasysht sepse po biem në pozita të palakmueshme ndaj qytetarëve që kërkojnë mbështetje.

Argjend Thaçi:Urdhëro, Halil!

Halil Morina:Në çdo seancë ne i kemi nga 5-6 kërkesa të kësaj natyre dhe gjithë kategoria e subvencioneve me u përqendru këtu nuk do të na mjaftonte, kështu që ne duhet të ja bëjmë një zgjidhje kësaj sepse nëse përballemi gjithmonë kështu do ta kemi problem.Unë mendoj që ta lëjme 1.500euro.

Argjend Thaçi: Kush është për miratimin e kërkesës nr.02/111 datë:27.02.2023, e parashtruar nga Sala Krasniqi, ti ndahet shuma prej 1.500euro për ndihmë finaciare për trajtim shëndetësor?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 1.500euro.

Pika e radhës është: Kërkesa nr. 02/137 datë: 14.03.2023, e parashtruar nga Naile Kastrati, kush është për ti ndahet shuma prej 1.500euro për ndihmë finaciare për trajtim shëndetësor?

Me vota unanime i ndahen 1,500euro edhe kësaj kërkesë.

Pika e radhës është: Kërkesa nr.02/141 datë: 16.03.2023, e parashtruar nga Shahe Thaçi. Kush është për ndarjen e mjeteve prej 1,500euro për këtë kërkesë për trajtim shëndetësor?

Me vota unanime, kësaj kërkesë i ndahen 1.500euro.

Pika e radhës e kësaj mbledhje është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/151 datë:20.03.2023, e parashtruar nga Lema Paqarizi. Kush është për që kësaj kërkesë të i ndahet shuma prej 1,500euro për trajtim shëndetësor?

Me vota unanime, miratohet dhe kjo kërkesë.

Pika tjetër është shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/247 datë:18.05.2023, e parashtruar nga Gentrin Krasniqi. Kush është për që kësaj kërkesë të i ndahet shuma prej 1,500euro për trajtim shëndetësor?

Me vota unanime, miratohet dhe kjo kërkesë.

Pika tjetër është: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/160 datë:27.03.2023, e parashtruar nga Rexhep Gegaj. Kush është për që kësaj kërkesë të i ndahet shuma prej 1,500euro për trajtim shëndetësor?

Me vota unanime, miratohet dhe kjo kërkesë.

Pika e radhës është: Kërkesa për pages për anëtar të logjistikës të cilët kanë marrë pjesë në komisionin për zgjedhjen e këshillave lokale, një formë të vendimit për kompenzim.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina: Ne si Komision e kemi shqyrtuar këtë qështje pasi që dy anëtarë të logjistikës kanë bërë një punë të jashtëzakonshme në mbështetje të Komisionit, e tërë logjistika ka qenë në duar të tyre e kanë bërë një angazhim maksimal. Ne duhet me gjetë një mënyrë se si duhet ti paguajm ashtu si paguhemi ne si Komision. Unë kisha thënë që mëditjet për këta dy anëtarë të Komisionit të jenë nga 50E për çdo mbledhje.

Argjend Thaçi: 16 anëtarë jemi prezent, urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Në disa këshilla e kemi marrë dhe një person nga po ai këshill nga po ai Kuvend dhe e kemi fut si pjesë të Komisionit, si kanë me u trajtu ata emra?

Argjend Thaçi: Ai është i barabartë me anëtarët e tjerë të Komisionit, siq e ka parapar udhëzimi administrativ. Në vendim ceket anëtarët e Komisionit por anëtari i 7 nuk ka mundur me u caku sepse nuk është ditë kush është ai person.

Kush është për që të dy anëtarët e logjistikës të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet e këshillave lokale, të merret vendimi që të ju ndahen mjetet prej 50.00E për çdo mbledhje të Këshillit lokal?

Me vota unanime, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Të ndryshme a ka ndonjë gjë?

Urdhëro Valon Mazreku!

Valon Mazreku: Kjo pika të ndryshme është njëra prej pikave të cilën e kemi injoruar, e kam një pyetje për Drejtorin e Kulturës edhe pse nuk qenka këtu Drejtori por ndoshta na përcjell, e kam parë kur ishin dy festivalet folklorike që e përgëzoj në radhë të parë Kryetarin, Qeverin dhe të gjithë ata persona të cilët kanë qenë të angazhuar për organizimin e këtyre dy festivaleve. Ajo qfarë më ka dhënë një shije jo të mirë është postimi i Drejtorit kur festivali ka qenë duke vazhduar ai e ceki: një projekt i realizuar në përpikmëri. Nëse është projekt i Drejtorit, a është pronar i OJQ-së e cila ka investuar në këtë festival, a është përfaqësues i OJQ-së. Si postim nuk ka qenë në rregull.

Argjend Thaçi: Pasi që pikat e kësaj mbledhje përfunduan ju falenderoj që ishit të pranishëm, mbledhjen e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:05.

Procesmbajtësja:

Argenitë Krasniqi



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

